



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 237/2 prot.

Tiranë, më 13.04.2018

V E N D I M

Nr. 24, datë 13/04/2018

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË NJËSINË E VETËQEVERISJES
VENDORE, BASHKIA MEMALIAJ DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT
PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E LIGJSHMËRISË.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Memaliaj,

VËREJ SE:

Me vendimin nr. 212, datë 25.10.2017, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Këlcyrë dhe në Bashkinë Memaliaj”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin, Bashkia Memaliaj.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me programin e mbikëqyrjes nr. 1723/1 prot., datë 25.10.2017, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën

nr. 1723/2 prot., datë 25.10.2017 “Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në Bashkinë Memaliaj, i është njoftuar këtij institucioni.

Bashkia përfshihet si subjekt i mbikëqyrjes së Komisionerit, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projekt raportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 237 prot., datë 06.02.2018, të Komisionerit, “Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në Bashkinë Memaliaj, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë një afat 15 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me materialin, ka dërguar disa observacione, nëpërmjet shkresës nr. 165/2 prot., datë 23.02.2018, “Dërgohet observacioni”, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 237/1prot., datë 27.02.2018, të cilat janë analizuar me hollësi në përmbajtjen e raportit përfundimtar dhe u administruan në dosjen e mbikëqyrjes.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të përgatitur nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Memaliaj, dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Për të rregulluar ligjshmërinë në lidhje me materializimin e skemës së administrimit të shërbimit civil, në strukturën organizative të institucionit, në përputhje me nenet 4 dhe

19, të ligjit për nëpunësin civil, njësia përgjegjëse e institucionit duhet të veprojë sipas këtij rendi:

- ✓ Të fillojë menjëherë punën për saktësimin e pozicioneve të cilat kanë karakteristikat e shërbimit civil, të përfshira në njësitë e strukturës aktuale në rastin e agjencive dhe njësive administrative, duke i materializuar edhe në vendimin e miratimit të strukturës organizative.
- ✓ Të hartojë menjëherë përshkrimet e punës në bashkëpunim me të gjithë aktorët e ngarkuar nga ligji me këtë detyrë (*analistin e punës, eprorin direkt dhe nëpunësin civil*), në përputhje me kërkesat e ligjit për shërbimin civil, për të gjitha pozicionet e punës që përfshihen në shërbimin civil, duke pasur parasysh aktin nënligjor që rregullon përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës (*vendimi nr. 142/2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar*), si dhe orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar.
- ✓ Njësia përgjegjëse, pasi të ketë finalizuar procesin e analizës funksionale të veprimtarisë së institucionit dhe të ketë përcaktuar pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, t'i paraqesë Kryetarit të Bashkisë, propozimin për ndryshimin e strukturës organizative, për pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, në përputhje me nenin 19, të ligjit për nëpunësin civil. Struktura të shoqërohet nga njësia përgjegjëse me një relacion spjegues, si dhe me përshkrimet e punës, të miratuara në përputhje me ligjin, duke i emërtuar njësitë përbërëse të saj, si drejtori të përgjithshme, drejtori apo sektorë, në varësi të funksionimit të tyre, duke mbajtur parasysh aktin nënligjor që rregullon pagat në shërbimin civil, si dhe orientimet e dhëna në raportin përfundimtar.
- ✓ Për të gjithë punonjësit që aktualisht punojnë në pozicione pune, të cilat gabimisht nuk janë trajtuar si pjesë e shërbimit civil, njësia përgjegjëse të realizojë deklarin e statusit të punësimit, për ata punonjës që janë gjendur në këto pozicione në datën 26.02.2014, e cila shënon edhe momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil dhe të ndërpresë marrëdhënien e punës për ata punonjës që kanë filluar punën në kundërshtim me kërkesat e ligjit, pas kësaj date.
- ✓ Nisur nga roli specifik që ka njësia përgjegjëse në institucionet e vetëqeverisjes vendore, duhet të vlerësohet organizimi i saj në nivel drejtorie, duke pasur parasysh faktin se, ligji për nëpunësin civil, e përcakton si mekanizëm vendimmarrës në të gjitha aspektet e administrimit të shërbimit civil në institucion (*rekrutimi, ristrukturimi, ecuria disiplinore, trajnimi, vlerësimi i punës, përshkrimi i punës, etj*), kompetenca që nuk mund ti zhvillojë një nëpunës i nivelit të ulët ose ekzekutiv, ashtu si e parashikon edhe akti nënligjor që e rregullon këtë aspekt të ligjit.
- ✓ Njësia përgjegjëse të informojë Komisionerin për çdo veprim që do të realizohet në këtë drejtim, pasi ky proces do të ndiqet dhe asistohet nëpërmjet Sekretariatit që mbështet veprimtarinë e Komisionerit, me qëllim që të lehtësojë dhe orientojë njësinë përgjegjëse për të rishikuar dhe standardizuar strukturën e pozicioneve të punës që janë pjesë e

shërbimit civil, për të mundësuar unifikimin e zbatimit të ligjit dhe mobilitetin e nëpunësve civilë të institucioneve të administratës vendore, në të gjithë shërbimin civil.

3. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, duhet të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2017 dhe në vijim, për vitin 2018, duke orientuar edhe aktorët e tjerë të procesit, ndër të cilët eprorët e drejtpërdrejtë, sipas orientimeve të dhëna në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, si dhe të sigurojë respektimin e afateve të vendosura për realizimin e këtij procesi.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, të përfshihet në Regjistrin Qendror të Personelit, formulari i vlerësimit për çdo nëpunës civil.

4. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Memaliaj, për vitin në vijim, të hartojë planin vjetor të pranimeve të reja në shërbimin civil, sipas kërkesave të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për planin vjetor të pranimin në shërbimin civil”*, si dhe bazuar në orientimet e Komisionerit në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes.
5. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Memaliaj, në kushtet e ristrukturimit të institucionit, pas miratimit të strukturës për vitin 2018, të respektojë kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, që rregullon procedurat ligjore gjatë aplikimit të këtij procesi, si dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
7. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Memaliaj, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të paraqesin të gjitha aktet administrative që vërtetojnë masat e marra.
8. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Memaliaj të njoftojë për këtë vendim të gjithë subjektet e ngarkuara me detyra specifike prej ligjit për nëpunësin civil, në rolin e eprorit direkt, Zyrtarit Raportues, Zyrtarit Kundërfirmues dhe Zyrtarit Autorizues, në këtë institucion, të cilët do të mbajnë përgjegjësi personale për mos respektimin e kërkesave të ligjit për nëpunësin civil, në rast se nuk veprojnë për të rivendosur ligjshmërinë brenda afatit të vendosur nga Komisioneri për zbatimin e këtij vendimi.
9. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Memaliaj dhe njësia përgjegjëse e institucionit, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë dhe Ministria e Brendshme.

10. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha